

NOTE INFORMUESE

Mbi kërkesën e ILD për procedim disiplinor me masën « Shkarkim nga detyra » për magjistratin E.R.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor mbi bazë ankese ndaj magjistratit E.R. prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Hetimi ka verifikuar një sërë ankesash të ardhura nga 3 qytetarë të ndryshëm me pretendime për zvarritje të hetimeve paraprake, shkelje në hetimet e procedimit penal, mospërbushje të detyrës lidhur me grumbullimin e fakteve dhe provave, mosdhënie informacioni.

Hetimi i kryer nga Inspektorët e ILD ndaj magjistratit E.R., ka konstatuar:

- Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale, të cilat nuk justifikohen nga shkaqe të tjera të arsyeshme personale, familjare, të cilat janë të lidhura direkt me magjistratin;
- Kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte;
- Përvojën e magjistratit në sistemin gjyqësor, si tregues ky i njohjes shumë të mirë të tij mbi rolin e ushtrimit të detyrës me disiplinë, si dhe vlerësimet e tij profesionale;
- Pasojat e shkeljes disiplinore lidhur me respektimin e afateve të përfundimit të hetimeve paraprake në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit procedural penal;
- Si pasojë e mosveprimit të magjistratit është cënuar prestigji i figurës së prokurorit, si dhe është cënuar besimi i publikut të drejtësisë;
- Sjellja e papërshtatshme nuk shtrihet vetëm tek magjistrati subjekt hetimi disiplinor, por rrezikon të ndiqet si shembull nga magjistratë të tjerë, si dhe krijon terren për sjellje të papërshtatshme edhe në raste të tjera të ngjashme;

ILD arrin në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit E.R. përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore” dhe i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë *caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”* të parashikuar nga neni 148/d, pika 2/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni dhe 111 të ligjit nr. 96/ 2016, për magjistratin E.R.